

- Sigurimin e shërbimeve për mbështetje ligjore dhe ekonomike për gratë sipërmarrëse të tashme dhe të ardhëshme, si dhe këshilla individuale për çështje të ndryshme ligjore dhe ekonomike.

• Rritja e aktivitetit ekonomik në prodhimtari, tregti dhe shitjen e produkteve vendore.

• Hartimi i politikave dhe masave të reja për autoritetet vendore dhe kombëtare për të mbështetur gratë në zhvillimin e biznesit të tyre dhe avancimin në një kohë të gjatë.

### Projektin e implementojnë:

#### Qendra për menaxhim me ndryshimet (QMN)

Rr. "Rajko Zhinzifov" 44/1, 1000 Shkup

Web-faqja: [www.cup.org.mk](http://www.cup.org.mk)

E-mail adresa: [info@cup.org.mk](mailto:info@cup.org.mk)

Tel dhe fax: +389 2 6092-216

#### Qendra për studime komparative dhe ndërkombëtare(QSKN)

Rr.Elbasanit pallati filipeu nr.4e, Tiranë

Web-faqe: <http://www.qskn.al/>

E-mail adresa: [gskninfo@gmail.com](mailto:gskninfo@gmail.com)

Tel.: +355 67 28 72 736

#### Instituti për të drejtat e njeriut(IDNJ)

Adresa: rr. „Rajko Zhinzifov“ 49A, 1000 Shkup

Web faqja: [www.ihr.org.mk](http://www.ihr.org.mk)

E-mail adresa: [ihr@ihr.org.mk](mailto:ihr@ihr.org.mk)

Tel.: (+389) 2 3243 331

#### Fondacioni Egalite

Rr. 101/1, 1221 Kamjan, Tetovë

Web-faqja: [www.foundationegalite.org](http://www.foundationegalite.org)

E-mail adresa: [infofondacija@gmail.com](mailto:infofondacija@gmail.com)

Tel: 078 275 919

Ky botim u përpunua në kuadër të projektit "Projekti për zhvillimin e mikro-ndërmarrjeve të grave në zonën ndërkufitare", financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian. Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë që të pasqyrojë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Institute for Human Rights



# PROJEKTI I ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA PËR GRATË NË ZONËN NDËRKUFITARE

Проект за развој на микро-претпријатија на жени во прекуграничната област

Microenterprise development project for women in the cross-border area



## Përshkrim i shkurtër i projektit

Projekti do të ndihmojë në themelimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla të grave në zonën ndërkufitare ndërmjet rajonit të Pollogut dhe Elbasanit. Projekti ka për qëllim të rrit konkurrencën e ndërmarrjeve të vogla në pronësi të grave, si dhe të nxis dhe përforcon sipërmarrësinë te gratë. I njeiti do të ketë për detyrë t'i vërtetojë pengesat me të cilat ballafaqohen gratë në punën me bizneset e tyre dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla në pronësi të grave në rajonin e përmendur.

Projekti do të përfshijë gra me ide për të filluar biznes, si dhe gra sipërmarrëse të cilat tani më kanë themeluar bizneset e tyre dhe punojnë në nivel të ndërmarrjeve të vogla. I njeiti do të ju sigurojë mbështetjen e duhur për t'i përforcuar aftësitë e tyre afariste për të udhëhequr me ndërmarrjen dhe të sigurojë ndihmë shtesë teknike që të mundet gratë t'i zhvillojnë dhe zgjerojnë bizneset e vogla dhe mikro bizneset në lëminë ndërkufitare.



## Ndërmarrjet e vogla të grave- kuptimi dhe roli i tyre

Në kushte të papunësisë së lartë, shumë rëndë hapen vende të reja pune, ndërsa konkurenca për një vend të caktuar pune është shumë e lartë. Prandaj kërkohen mënyra tjera për t'ju ndihmuar grave të papunësuar. Në të njëjtën kohë vetëpunësimi dhe themelimi i bizneseve të veta shifet si një mundësi e shkëlqyer që t'ju ndihmohet atyre që kërkojnë mënyrë për përfitim të përshtatshëm, që të bëjnë diçka afatgjate për vete dhe familjet e tyre.

Mikro ndërmarrjet në pronësi të grave kanë rol shumë të madh në zhvillimin e ekonomisë dhe punësimit, posaçërisht në veprimtari të caktuara në tregti dhe shërbime nga lëmi më të ndryshme si kënde lojrash, qendra të ndryshme edukative, trening dhe relaks, pastaj shërbime kozmetike dhe sallone ondulimi, por gjithashtu edhe prodhim të konfeksionit, punë dore, suvenire, mobilje, ushqime dhe ëmbëlsira etj. Mikro ndërmarrjet e grave kanë shumë ndikim në të gjithë veprimtaritë shoqëruese lidhur me turizmin dhe hotelierinë/mikëpritjen, dekorim dhe art, teknologji informative dhe komunikim. rojekti posaçërisht do të nxis sipërmarrësinë te gratë dhe ate jo vetëm ato të lartëpërmendurat, por edhe te të gjithë lëmitë tjera, posaçërisht ato tek të cilët gratë mungojnë ose ka numër më të vogël.

## Lëmitë e implementimit dhe periudha e realizimit

Projekti do të implementohet në zonën ndërkufitare me fokus të veçantë rajonin e Pollogut dhe Elbasanit. Periudha e realizimit fillon në prill 2018 vit dhe do të zgjas dy vite e gjysëm, deri në shtator të vitit 2020.

## Shfrytëzuesit dhe grupet e shfrytëzuesve

Grupi qëllimor i këtij projekti janë gratë sipërmarrëse të ardhëshme gjegjësisht ato të cilat kanë ide për biznese në pronë të tyre, si dhe ato të cilat tani më kanë themeluar ndërmarrjet e tyre dhe merren me një veprimtari të caktuar që ju sjell ndonjë të hyrë, në rajonet e përmendura Pollog dhe Elbasan. Në mënyrë indirekte, shfrytëzues të fundit janë të gjithë familjet dhe banorët e Pollogut dhe Elbasanit të cilët do të kenë dobi nga përmirësimi i mirëqenies dhe rritja e të hyrave. Institucionet lokale dhe nacionale do të kenë gjithashtu dobi të madhe nga projekti në formë të konsultimeve adekuate që projekti do t'i bëjë me rrethin e biznesit dhe do të jep propozime për avancimin e politikave për sipërmarrësinë e grave dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonën ndërkufitare.

## Ndërtimi i aftësive për biznes dhe përparimi në punë

Në kuadër të projektit do të ndërtohen kapacitetet e grave sipërmarrëse rreth tre blloqeve të mbështetjes:

### 1. Ndërtimi i aftësive dhe kapaciteteve për udhëheqje dhe menaxhim të ndërmarrjeve të tyre

Kjo pjesë përfshinë ndërtimin e vetëbesimit dhe fillimin e biznesit vetanak, avancimin e aftësive për biznes vetanak, si dhe përmirësimin e aftësive për operacionet administrative dhe financiare, parashikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe pjesën që lidhet me ndihmën dhe mbrojtjen adekuate ligjore dhe informatat adekuate për mbledhjen e tatimeve, taksave dhe detyrimeve të tjera ligjore.

### 2. Përmirësimi i prodhimitarisë dhe të hyrave në ndërmarrjet ekzistuese mikro

Ky seksion përfshinë mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve të kompanive që lidhen me dizajnimin dhe zhvillimin e produkteve të reja, rritjen e volumit të prodhimit, përmirësimin e shitjeve dhe marketingut, marketingun e zgjeruar, rrjetet e duhura dhe takimet B2B në rajonet dhe në shkallë kombëtare. Brenda kësaj pjese, ekzistojnë edhe aktivitete adekuate për krijimin e dyqanit on-line për shitjen e produkteve.

### 3. Revizioni i politikave për zhvillim të mikro-ndërmarrjeve dhe mbështetjen e sipërmarrësisë së grave.

Kjo pjesë përfshinë organizimin e tryezave të rrumbullakta me përfaqësues nacional dhe regjional të institucioneve qeveritare, rrethit të biznesit, bankat dhe institucionet e tjera financiare, si dhe të gjithë aktorët përkatës të politikës në aspektin e sipërmarrjes së grave dhe zhvillimit afatgjatë të ndërmarrjeve mikro. Është parashikuar gjithashtu zhvillimi i duhur i masave të reja dhe të rishikuara për përkrahjen dhe promovimin e sipërmarrjes së grave.

## Efeki përfundimtar dhe rezultatet e projektit

Në bazë të qëllimeve të propozuara dhe aktiviteteve të ndërmarra, priten pesë rezultate kryesore:

- Përmirësim të aftësive dhe kompetencave në menaxhimin e biznesit dhe forcimin e qëndrimeve sipërmarrëse dhe vlerave të biznesit.
- Ofrimin e shërbimeve këshillëdhënëse për gratë sipërmarrëse për të rritur aktivitetet ekonomike dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro.

